1.2	Njesia Administrative Miras	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	44.00	58.00	58.00	0.00
1.3	Njesia Administrative Qender Bilisht	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	22.00	36.00	44.00	0.00
1.4	Njesia Administrative Proger	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	28.00	48.00	52.00	0.00
1.5	Njesia Administrative Hocisht	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	32.00	47.00	41.00	0.00
2	**NR. I FUSHATAVE NDERGJEGJESUESE MBI REZIKSHMERINE NGA KONSUMI I USHQIMEVE TE PA SIGURTA**	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	56.00	76.00	80.00	0.00
2.1	Institucione	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	18.00	43.00	50.00	0.00
2.2	Popullate	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	38.00	33.00	30.00	0.00

Raporti: **PBA9 - Informacion mbi Programin**

NJVQV: 105 - Bashkia Devoll

Programi: AE105 - Bujqësia, Mjedisi dhe Pyjet

PBA: 2025 - 2027

		FUNKSIONI	TË PËRGJITHSHME	2020	2021	2022	2023	2024
3	**NR. I QENVE NE RRUGE QE PERFITOJNE SHERBIME (VAKSINOHEN)**	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	78.00	94.00	70.00	0.00
4	**NR.ANKESASH NE LIDHJE ME PROBLEMATIKAT USHQIMORE TE RAPORTUARA.**	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	24.00	28.00	34.00	0.00
5	**NR I KONTROLLEVE MBI INFLUENCEN AVIARE H5N8.**	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	0.00	0.00	16.00	28.00	0.00	0.00
6	**NR.MJETESH PER UJITJEN -KULLIMIN**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0.00	0.00	6.00	6.00	7.00	0.00
7	**NR. I PERFITUESVE NGA SKEMAT UJITESE (NR.FERMASH)**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0.00	0.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00	0.00
8	**NR I PERFITUESVE (FAMILJE) NGA SHERBIMI I UJITJES DHE KULLIMIT (PROGRESIVE)**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0.00	0.00	8,800.00	9,000.00	9,000.00	9,000.00
9	**SISTEMI KULLUES NE KM LINEAR**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	2,365.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
10	**SIPERFAQE BUQESORE E MBULLUAR ME KULLIM (NE HA)**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	12,680.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
11	**SIPERFAQE BUQESORE E PERMIRESUAR NE KULLIM (NE HA) PER VITIN**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0.00	0.00	1,500.00	1,800.00	1,900.00	0.00
12	**KANAL UJITES I PASTRUAR DHE REHABILITUAR NE KM**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0.00	0.00	120.00	120.00	120.00	120.00
13	**SISTEMI VADITES I BETONIZUAR NE KM LINEAR.**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0.00	0.00	150.00	150.00	150.00	150.00
14	**SIPERFAQE BUQESORE E MBULLUAR ME UJITJE (NE HA)**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0.00	0.00	4,000.00	4,100.00	4,100.00	0.00

Raporti: **PBA9 - Informacion mbi Programin**

NJVQV: 105 - Bashkia Devoll

Programi: AE105 - Bujqësia, Mjedisi dhe Pyjet

PBA: 2025 - 2027

		FUNKSIONI	TË PËRGJITHSHME	2020	2021	2022	2023	2024
15	**SIPERFAQE E TOKES BUQESORE NE HA (FONDI BUQESOR SIPAS INVENTARIT)**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	15,429.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
16	**SIPERFAQE E TOKES SE KULTIVUAR NE HA.**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	12,600.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
17	**SIPERFAQE TOTALE E FONDIT PYJOR KULLOSOR NE HA.**	04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	13,643.94	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
18	**SIPERFAQE NE HA PYJORE ,KULLOSORE E INVENTARIZUAR HIPOTEKUAR.**	04260 - Administrimi i pyjeve dhe kullotave	0.00	0.00	0.00	0.00	848.00	0.00

Raporti: **PBA9 - Informacion mbi Programin**

NJVQV: 105 - Bashkia Devoll

Programi: AF105 - Rezerva & Kontigjenca

PBA: 2025 - 2027

		FUNKSIONI	TË PËRGJITHSHME	2020	2021	2022	2023	2024
1	**RASTE TE PERDORIMIT TE FONDIT REZERVE DHE KONTIGJENCES**	04910 - Fondi rezervë	0.00	0.00	0.00	11.00	6.00	0.00

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHERBIMEVE FINANCIARE DNE BUXHETIT
SEKTORI 1 PLANIFIKIMIT TE BUXHETIT

Nr.1765/1 Prot. Bilisht më, 16.09.2024

Lënda : Dërgojmë projekt – dokumentin e rishikuar te programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
Drejtoria e Financave Vendore

Në zbatim të ligjit 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar , Udhezimit nr. 16 date 20.07.2016 ' 'Per Pergjegjesite dhe Detyrat e Kordinatorit te Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Kordinatorit te Riskut ne Njesite Publike", udhezimit nr.21 date 25.10.2016 "Per Nepunesit Zbatues te te gjitha niveleve" pika 2.1.4.udhezimit nr. 3 date 28.02.2024 "Per pergatitjen e programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027 po ju dërgojmë materialin për përfundimin e fazës së dyte te programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Ju falenderojmë per mirekuptimin!

KRYETARI BASHKISË

Eduard DURO

Adresa: Bashkia Devoll,Lagjia nr.l Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel & Fax +35581 123815-22288, e-mail bashkiadevoll@gmail.comt

Lista e Shkurtimeve

PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV – Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP – Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS – Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE – Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT – Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT – Instituti i Statistikave
PBB – Produkti i Brendshëm Bruto

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthejnë në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës* së *Programit,* synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e perfomancës të lidhura me ato në terma SMART[1]. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë[2] (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjecare[3], sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

[1] Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

[2] 'Afatgjat' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

[3] Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit,* synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart[4] i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave

[4] Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"

buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2025-2027 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavaneve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe Formatet e reja për planifikimin e shpenzimeve të programit.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË DEVOLL/QARKUT KORÇË 2025-2027

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Devoll/Qarkut Korcë gjatë periudhës 2025-2027, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2025-2027, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2025-2027. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia sipas raportit PBA8 bashkengjitur ketij materiali.

Raporti PBA9 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj. Kjo paraqitet ne materialin bashkengjitur .

2.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Devoll /Qarkut Korce në vitet 2025-2027

2.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Devoll /Qarkut Korce për vitet 2025-2027

Kjo nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.
Ne lidhje me te ardhurat per vitet 2025-2027 Bashkia Devoll eshte bazuar ne PBA-ne 2025-2027 dhe nuk ka kryer ndryshime drastike ne parashikimin e te ardhurave dhe duke u bazuar dhe ne vendimet e Qeverise Qendrore dhe duke pare klimen e biznesit dhe gjithashtu nevojen per hapjen e Bizneseve te reja ne vitet ne vazhdim nuk parashikon rritje ne taksat dhe tarifat vendore gjithashtu dhe ne planet e pergjithshme ne parashikimin e te ardhurave me vite.
Taksa mbi pasurine e paluajtshme shkaku i kesaj rritje vjen jo nga rritja e vleres rreferuese te cmimit per meter katror per njesi, por nga evidentimi ne terren i te gjitha siperfaqeve pronesore dhe aplikimi i VKM nr .132 date 07.03.2018 " Per metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme 'ndertesa' e bazes se takses per kategori specifike ,natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per peracaktimin e bazes se takses ,si dhe kritereve dhe rregullave per vleresimin alternative te detyrimit te Takses". Me ane te aplikimit faktik te kesaj VKM mendohet rritja ne vlere e takses se nderteses dhe te truallit gjithashtu dhe tokes bujqesore.
Taksa e ndikimit ne infrastukture nga ndertimet e reja gjithashtu shprehet me nje rritje 10% nga viti ne vit, efekti vjen kryesisht nga miratimi i planit vendor te Bashkise Devoll i cili ka sjelle nje rritje te vazhdueshme ne te ardhurat per kete takse.
Ne seksioni ***te ardhura nga taksat e ndara*** nuk kemi parashikuar asnje ndryshim ne planin afatmesem te ardhurave duke lene te gjitha zerat e te ardhurave ne te njejtin nivel.
Seksioni ***te ardhura nga tarifat vendore*** ne menyre te detajuar shprehen te gjitha tarifat qe Bashkia Devoll aplikon dhe te vetmet tarifa qe ndryshojne jane:

Tarifa e pastrimit dhe e ndricimit per Biznese kjo tarife rritet me nje vlere 10% jo per shkak se do rritet vlera e pastrimit dhe e ndricimit per bizneset por mendohet se pas kalimit te pandemise globale Covid-19 do rritet numri i bizneseve ne Bashkine Devoll gjithashtu dhe favorizimi i klimes se Biznesit nga ana e Bashkise me politika lehtesuese cka do sjelle nje rritje ne vleren e ketyre tarifave .Tarifa per dhenie licnese per tregetimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj peson nje rritje ne planin e parashikimit te ardhurave per vitin 2025 per shkak se autorizimi 5 vjecar i subjekteve qe tregetojne nafte rinovohet ne ate vit.

Ne seksionin ***te ardhura te tjera*** nuk kemi parashikuar asnje ndryshim ne vlere te ardhurave ketu perfshihet dhe akumulimi i llogarise debitore e cila parashikohet me ulje nga viti ne vit me nje vlere 10% si pasoje e marjes se masave te ndryshme shtrenguese per debitoret e ndryshem familjare dhe Biznes .

Por kryesisht rritja e planit afatmesem te ardhurave ne disa nga zerat e specifikuar me lart vjen si pasoje e besimit se miremenaxhimi dhe mbledhja më me efiktivitet i te gjitha taksave dhe tarifave nga strukturat pergjegjese . Raporti PBA2 per parashikimin e te ardhurave paraqitet bashkengjitur.

2.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Devoll /Qarkut Korce

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.
Taksat vendore jane parashikuar mbi numrin e bizneseve qe operojne ne territorin e Bashkise Devoll. Per vitin 2024 jane parashikuar 490 biznese dhe per 3 vitet ne vazhdim jane parashikuar nga 500-510 deri ne vitin 2026. Taksa e ndikimit ne infrastrukture zbatohet per zhvillimet qe kerkojne paisjen me leje ndertimi e cila llogaritet mbi cmimin reference ore preventivin e investimit te ri. Kjo takse llogaritet permes Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV); dhe Plan i Detajuar Vendor ne zonat te cilat do te kete zhvillim dhe prioritet . Ne total disponojme nje Plan te Pergjithshem Vendor dhe nje Plan te Detajuar Vendor. Ne taksen mbi veprimtarine e sherbimit hotelier kemi parashikuar te ardhura mbi numrin e hoteleve te cilat parashikohet te jene te njejte ne numer per vitet 2025-2027. Numri total I hoteleve qe ushtrojne veprimtarine e pyre parashikohet 5.

A.2 Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:
a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

Ne tarifat per mbledhjen dhe largimin e mbledhjeve eshte parashikuar ne baze te numrit te pergjithshem te familjeve me 13.463 familje e parashikuar kjo shifer ne rritje nga 13663 deri ne 13.720 per periudhen 2025-2027. Ne tarifat vendore jane parshikuar edhe tarifat per cdo sherbim qe kryhen Bashkia. Ne total Bashkia kryhen 79 sherbime administrative per qytetaret. Per sa i takon tarifes se vendosur ne cerdhe eshte planifikuar per 25 femije te cilet trajtohen me ushqim.

B. Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta.
Bashkia Devoll disponon nje territor pyjor dhe kullosor me siperfaqe prej 13,643.9 ha nga e cilat 198.42 ha e ka leshuar me qera. Kjo siperfaqe eshte e ndare ne siperfaqe pyjore te dhena me qera 112.42 ha dhe siperfaqe kullosore 86.8 ha.

C. Të Ardhura të Tjera të Veta

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

2.1.1.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera. Per vitin 2024 ky ze eshte parashikuar 5.000.000 leke dhe per periudhen 2025-2027 eshte parashikuar me nje rritje 12%

B. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë. Kjo takse mblidhet nga Drejtoria Rajonale e Sherbimit Rrugor . Vitin 2024 eshte parashikuar ne vleren 11 milion leke dhe po kjo vlere edhe per periudhen 2025-2027.

C. Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjëse për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.
Ne territorin tone nuk ka subjekte te licensuara per ushtrim aktiviteti ne industrine Minerare. Dhe per vitin 2024 dhe ne vazhdim nuk parashikojme te ardhura nga renta.

D. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

2.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

1. Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së. Madhësia e transfertës së pakushtëzuar është 1.01% e PBB-së së viteve 2025-2027. Në përllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2023, kriteret e përdorurara dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2025-2027 janë: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), dendësia e popullsisë për km², numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

2.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

2. Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së. Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.
   Bashkitë në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 duhet të parashikojnë fonde për ofrimin e infrastrukturës së përshtatshme për ushtrimin e funksionit të arsimit parashkollor.

2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Devoll /Qarkut Korce për periudhën 2025-2027

Raporti PBA3 paraqet shpenzimet aktuale, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2022 deri në 2027. Bashkengjitur do te gjeni raportin me te dhenat per periudhen.

3. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE

Buxheti total i Bashkisë Devoll/Qarkut Korce menaxhohet sipas 5 programeve per 20 funksionet qe i perkasin Pushtetit Vendor. Ky seksion i dokumentit të PBA-së paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë. Çdo nën-seksion paraqet informacionin e performancës të planifikuar dhe kostot përkatëse për një program. Për secilin program informacioni i paraqitur konsiston në:

- Shpenzimet totale të programit sipas kategorisë ekonomike (paga dhe sigurime, shpenzime korente dhe shpenzime kapitale) për dy vitet e kaluara (fakti), vitin aktual (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme (parashikimi);
- Politika e Programit (qëllimet e politikës së programit, objektivat e programit dhe treguesit përkatës të performancës);
- Planet e shpenzimeve të Produkteve të Programit;
- Projektet e investimeve; dhe
- Të dhëna dhe statistika të përgjithshme të programit.

Sipas programeve bashkengjitur paraqiten tabelat me qellimet dhe objektivat per secilin, si dhe raportet me te dhenat financiare deri ne nivel produkti.

Punoi :
Drejtore e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit
Aurela Furxhi

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
KRYETARI

Nr. 662/1 prot. Bilisht më, 04.03.2024

Lenda : Njoftim per takim te GMS-së

GRUPIT TË MENAXHIMIT STRATEGJIK

Në zbatim të ligjit 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 " Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar , Udhezimit nr.16 date 20.07.2016 "Per Pergjegjesite dhe Detyrat e Kordinatorit te Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Kordinatorit te Riskut ne Njesite Publike", udhezimit nr.21 date 25.10.2016 "Per Nepunesit Zbatues te te gjitha niveleve" pika 2.1.4.udhezimit nr. 03 date 28.02.2024 "Per pergatitjen e programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027" ju njoftoj per daten 05 Mars 2024 ora 13:00 per takimin e pare te diskutimit me Grupin e Manaxhimit Strategjik me tematiken si me poshte:

1. Miratimin e Misionit te NJVQV.
2. Diskutimin e DEMP dhe EMP.
3. Detajimin e kalendarit per pergatitjen e PBA-se.
4. Informimin e udhezimit per pergatitjes e PBA-se.
5. Shperndarja e udhezimit te brendshem .

KORDINATORE E G.M.S.-SE

Eliverta PAVLIQOTI

img20240304_13...

Aurela Furxhi
to eliverta, astrit.seferkolli, gentikeco1, xhensilapine17, bledi

14:42 (0 minutes ago)

Bashkengjitur do te gjeni urdherin nr.68 date 04.03.2024. Ju lutem njofton grupet e EMP-ve per vijueshmerine e punes.
Ju bej me dije se neser ne daten 05 Mars 2024 ora 13:00 kemi takimin e pare te GMS te njoftuar me shkresen nr.662/1 date 04.03.2024.
Duke ju falenderuar per mirekuptimin!

One attachment • Scanned by Gmail



img20240304_13...

Reply Reply to all Forward

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
KRYETARI

Nr. 662 prot.

Bilisht më, 04.03.2024

U R D H Ë R
Nr. 68 , datë 04.03.2024
PËR

NGRITJEN E GRUPIT PËR MENAXHIM STRATEGJIK (GMS)
DHE
EKIPEVE TË MENAXHIMIT TË PROGRAMEVE (EMP)
NË BASHKINE DEVOLL

Në zbatim të ligjit 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 " Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar , Udhezimit nr.16 date 20.07.2016 "Per Pergjegjesite dhe Detyrat e Kordinatorit te Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Kordinatorit te Riskut ne Njesite Publike", udhezimit nr.21 date 25.10.2016 "Per Nepunesit Zbatues te te gjitha niveleve" pika 2.1.4.udhezimit nr. 03 date 28.02.2024 "Per pergatitjen e programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027.

URDHËROJ:

1. Emërimin si kordinator i GMS-së znj. Eliverta Pavliqoti me pozicionin zv.Kryetare e Bashkise per hartimin e planit Buxhetor Afatmesem 2025-2027.
2. Emerimin si sekretare e GMS-Se znj. Aurela FURXHI pergjegjese e sektorit te buxhetit ne procesin e hartimit te Planit Buxhetor Afatmesem 2025-2027.
3. Ngritjen e Grupit për Manaxhim Strategjik per vazhdimin e procedurave te Buxhetimit afatmesem me perberjen si me poshte:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni në GMS	Funksioni në Bashki	Programi
1.	Eduard Duro	Kryetar i GMS	Kryetari i Bashkisë	
2.	Eliverta Pavliqoti	Koordinator i GMS[1] dhe Anëtar, DEMP	Zv.Kryetari	Menaxhim,Planifikim dhe sherbime mbeshtetese (AA105)
3.	Aurela FURXHI	Sekretar i GMS[2]	Nepunes Zbatues	Pergjejgese e Sektorit te Planifikimit te Buxhetit.
4.	Gentian Keco	Anëtar, DEMP	Drejtor i Agjencisë Utilitare,Komunitare,dhe Administrative.	Sherbime Publike Komunitare (AB105)

5.	Bledar Kanina	Anëtar, DEMP	Drejtor i Sherbimeve Sociale, Shendetsore dhe Strehimit	Sherbime sociale dhe strehimi (AC105)
6.	Xhensina Pine	Anëtar, DEMP	Drejtore e Agjencise se Arsimit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	Arsimi ,Arti, Kultura dhe Sporti (AD105)
7.	Astrit Seferkolli	Anëtar, DEMP	Sekretar i Përgjithshëm	Buqesia ,Mjedisi dhe Pyjet (AE105)
8.	Anita Kaso	Anëtar (pa të drejtë vendimmarrje)	Drejtues i Strukturës Përgjegjëse për Auditin	Specialist ne Auditin e brendshem

4. Ngarkohet Auditimi i Brendshem te marre pjese ne te gjitha mbledhjet e GMS pa të drejtë vote.

5. Ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programit për procedurat e Buxhetimit Afatmesëm sipas programeve buxhetore me përbërjen si më poshtë:

Programi	Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Pozicioni në EMP
Menaxhim,Planifikim dhe sherbime mbeshtetese (AA105)	1	Eliverta Pavliqoti	Zv.Kryetari	DEMP
	2	Adriana Rushitaj	Pergjegjese e sektorit te Burimeve Njerezore	Anëtar
	3	Remzi Kutrolli	Pergjegjes i projekteve me BE	Anëtar
	4	Elona Uzhuri	Pergjegjese e sektorit te zyrave me nje ndalese	Anëtar
	5	Marsel Mulla	Drejtor i Drejtorise te Inspektimit dhe mbrojtjes se Territorit	Anëtar
	6	Gazmend Malo	Pergjegjes i sektorit te te Ardhurave dhe mbledhjes se Borxhit	Anëtar
	7	Tatjana Spaho	Pergjegjese e Sektorit te Planifikimit & Zhvillimit te Territorit	Anëtar
Sherbime Publike Komunitare (AB105)				
	1	Gentian Keco	Drejtor i Agjencisë Utilitare,Komunitare,dhe Administrative.	DEMP
	2	Altin Cane	Pergjegjes i sektorit te sherbimeve dhe mirembajtjes	Anëtar
	3	Kristi Meslani	Pergjegjes i Sektorit te Sherbimeve te Transportit	Anëtar
	4	Elis Lengu	Pergjegjes i sektorit te ndricimit,dekorit,parqeve,hapesirat e gjelbra.	Anëtar
	5	Olgert Fifo	Specialist sherbimesh	Anëtar
Sherbime sociale dhe strehimi (AC105)				
	1	Bledar Kanina	Drejtor i Sherbimeve Sociale, Shendetsore dhe Strehimit	DEMP
	2	Marilda Bejleri	Pergjegjese e sektorit te kujdesit social dhe PAK	Anëtar
	3	Besmir Lata	Pergjegjes i sektorit te ndihmes Ekonomike	Anëtar
	4	Petrina Kocagogos	Pergjegjese e Qendres Sociale Multifunksionale	Anëtar
	5	Inva zyfi	Pergjegjese e Cerdhes se Femijeve	Anëtar
Arsimi ,Arti, Kultura dhe Sporti (AD105)				
	1	Xhensina Pine	Drejtore e Agjencise se Arsimit, Kultures, Rinise dhe Sporteve.	DEMP
	2	Matilda Meco	Pergjegjese e Sektorit te Arsimit	Anëtar
	3	Denada Babasuli	Pergjejgese e Kultures dhe Trashegimise Kulturore	Anëtar
	4	Kleo Kaprelli	Pergjegjes i Sektorit te Rinise dhe Sportit	Anëtar
	5	Hermalda Ago	Pergjegjese e Sektorit te Turizmit	Anëtar
Buqesia ,Mjedisi dhe Pyjet (AE105)				
	1	Astrit Seferkolli	Sekretar i Përgjithshëm.	DEMP
	2	Ermal Kello	Pergjegjes i Sektorit te Ujitjes dhe Kullimit	Anëtar
	3	Lisandri Cuko	Pergjegjes i sektorit te Buqesise & Mbrojtjes se Konsumatorit	Anëtar
	4	Edmir Cenolli	Pergjegjes i Inspektoriatit te Mbrojtjes se Pyjeve dhe Mjedisit	Anëtar
	5	Orgest Cenolli	Inxhinier pyjesh dhe mjedisi	Anëtar

I. Përgjegjësitë në proçesin e përgatitjes së Programit BuxhetorAfatmesëm 2025-2027.

1. Koordinatori i GMS ka përgjegjësi të plotë për koordinimin e procesit të PBA në Bashkinë e Devollit.
   - Propozimin e një kalendari të brendshëm tek GMS.
   - Propozimin në GMS të strukturës së programeve të shpenzimeve;
   - Propozimin në GMS të emrave të Drejtuesve të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve;

- Shpërndarjen për cdo EMP të udhëzimeve të brendshme të firmosura nga Kryetari i Bashkisë;
- Shpërndarjen për cdo EMP të Udhëzimit për Përgatitjen e PBA, së bashku me Anekset përkatëse.
- Propozimin në GMS të ndarjes së Tavaneve Përgatitore të PBA, sipas programeve të Bashkisë;
- Përcjelljen për nënshkrim tek Kryetari i NJVQV të të gjithë dokumentacionit të PBA-së;
- Monitorimin e respektimit të afateve të përcaktuara në kalendarin e proçesit;
- Raportimin tek GMS dhe Kryetari i Bashkisë të të gjitha shkeljeve, të evidentuara lidhur me ecurinë e procesit të PBA-së brenda Bashkisë.

2. Drejtuesi i EMP-së ka përgjegjësi të plotë për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit që drejton,për:
   - Propozimin e anëtarëve të tjerë të EMP-së
   - Të bëjë shpërndarjen për të gjithë anëtarët e EMP-së të materialeve lidhur me procesin e PBA-së;
   - Menaxhimin e proçesit të zbatimit të procedurave të PBA që lidhen me programin e tij;
   - Hartimin e një kalendari të brendshëm strikt për EMP;
   - Organizimin e mbledhjeve të EMP-së në etapa të ndryshme të procesit;
   - Arritjen e marrëveshjeve dhe konsensusit brenda EMP, për të gjitha etapat e procedurave;
   - Ushtrimin e autoritetit të nevojshëm për plotësimin e procedurave;
   - Miratimin e hedhjes në formatin standard të Qëllimit ; Objektivave dhe Produkteve të programit buxhetor;
   - Nënshkrimi i Raporteve standard , sipas Seksionit 3.3 të këtij Udhëzimi;
   - Raportimin tek koordinatori i GMS, i të gjitha rasteve të mosmarrëveshjeve që nuk mund të zgjidhen brenda EMP-së;
   - Rishikimi i Qëllimit; Objektivave dhe Produkteve për cdo sugjerim ose mos miratim nga GMS.

3. Sekretari i GMS-së mbështet Koordinatorin e GMS gjatë procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore nëpërmjet:
   - Këshillimit të Koordinatorit të GMS për përgatitjen e draftit të parë të shpërndarjes të Tavaneve buxhetore për cdo program buxhetor.
   - Ndihmon dhe oriention drejtuesit e EMP të programeve , mbi procesin e kostimit të aktiviteteve të programit;
   - Mbështet Kordinatorin e GMS në hartimin e informacionit përmbledhës të kërkesave buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore për t'u prezantuar në GMS, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Këshillin Bashkiak.
   - Mbështet Koordinatorin e GMS në dokumentimin e procesit të diskutimeve në mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

II. Vendimmarjet e GMS dhe EMP:

Pergatitja e procesit te PBA-se bazohet ne Vendimmarrjet e GMS-se dhe te EMP-se. Secila prej vendimmarjeve kerkon pune pergatitore, analiza dhe vendime. Secila prej vendimmarjeve do te shoqerohet me takime te grupeve perkatese.

GMS do te organizoje maksimumi 6 takime nder te cilat do te miratoje Misionin dhe Organizimin, deklaratat e politikes, hartimin e pemes se programit,shqyrtimin e planeve te shpenzimit,shqyrtimin e projekt dokumentit te PBA-se si dhe pergatitjen e kerkesave buxhetore.

EMP-te do te organizojne maksimumi 5 takime nder te cilat do te diskutoje udhezimet dhe dokumentat per pergatitjen e PBA-se, rishikon politiken e programit, qellimet e PP, Objektivat e PP, shqyrton tavanet e miratuara ne Keshillin Bashkiak Identifikon projektet aktivitetin dhe produktin, pergatit pemen e programit, diskuton dhe miraton specifikat e produktit, lidhjen e produkteve me objektivat dhe projektet, specifikimet e aktiviteteve sasite e produkteve , planifikon shpenzimet per aktivitetet, rishqyrton dhe miraton planin e shpenzimeve dhe pergatit versionin perfundimtar te raporteve dhe planeve te shpenzimeve.

6.Për zbatimin e këtij Urdhri, të gjithë drejtuesit e ekipeve të menaxhimit të programeve .

7.Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet GMS pranë Bashkise Devoll .

8.Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Eduard DURO

KRYETAR I BASHKISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

Konceptoi: Aurela Furxhi, Pergj.e sek.te Planifikimit te Buxhetit

Konf.Bazen ligjore: Eriksela AVDO ,Specialiste e Prokurimeve

Data: 04.03.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

KRYETARI

Nr. 662/2 prot. Bilisht më, 10.05.2024

U R D H Ë R

Nr. 68/1, datë 10.05.2024

PER NJE NDRYSHIM TE URDHERIT NR.68 DATE 04.03.2024 PER

"NGRITJEN E GRUPIT PËR MENAXHIM STRATEGJIK (GMS)
DHE
EKIPEVE TË MENAXHIMIT TË PROGRAMEVE (EMP)
NË BASHKINE DEVOLL"

Në zbatim të ligjit 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar , Udhezimit nr.16 datë 20.07.2016 "Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Kordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Kordinatorit të Riskut në Njësitë Publike", udhëzimit nr.21 datë 25.10.2016 "Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve" pika 2.1.4.udhëzimit nr. 03 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027.

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e pikës 3 dhe pikes 5 të urdhërit për anëtarin e GMS dhe Drejtuesin e Ekipit të Programit AC105 :
   Ishte Z. Bledar Kanina …..bëhet Znj.Zerina Sinani.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Eduard DURO

KRYETAR I BASHKISË

SHTOJCA 1

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2025-2027

Në mijë lekë

Bashkia	2024*			2025 (P)			2026 (P)			2027 (P)		
	Transferta e Pakushtëzuar	Transferta e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave	Totali	Transferta e Pakushtëzuar	Transferta e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave	Totali	Transferta e Pakushtëzuar	Transferta e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave	Totali	Transferta e Pakushtëzuar	Transferta e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave	Totali
Belsh	163,764	11,309	175,072	173,652	20,357	194,010	184,101	20,357	204,459	195,478	20,357	215,836
Berat	418,077	28,702	446,779	443,078	51,667	494,745	469,991	51,667	521,658	499,028	51,667	550,695
Bulqizë	350,683	16,182	366,865	371,859	29,130	400,989	394,342	29,130	423,472	418,707	29,130	447,838
Cërrik	199,627	13,998	213,625	211,682	25,198	236,879	224,446	25,198	249,644	238,316	25,198	263,513
Delvinë	86,948	11,645	98,593	91,936	20,962	112,899	97,583	20,962	118,545	103,610	20,962	124,573
Devoll	257,125	14,922	272,047	272,344 +15,219	26,861	299,205	288,899	26,861	315,761	306,748	26,861	333,610
Dibër	550,281	31,559	581,839	582,161	56,810	638,970	617,775	56,810	674,585	655,938	56,810	712,747
Divjakë	282,939	19,375	302,314	300,025	34,878	334,903	317,548	34,878	352,426	337,181	34,878	372,059
Dropull	106,820	10,973	117,793	112,764	19,752	132,517	119,370	19,752	139,122	126,741	19,752	146,493
Durrës	1,211,509	43,910	1,255,419	1,266,027	79,044	1,345,071	1,322,998	79,044	1,402,042	1,382,533	79,044	1,461,577
Elbasan	959,175	50,800	1,009,975	1,016,547	91,447	1,107,994	1,078,281	91,447	1,169,728	1,144,899	91,447	1,236,346
Fier	837,900	51,976	889,876	886,970	93,565	980,535	941,236	93,565	1,034,800	999,377	93,565	1,092,942
Finiq	160,443	11,561	172,004	170,132	20,811	190,943	180,359	20,811	201,170	191,504	20,811	212,316
F.Arrëz	103,802	11,561	115,363	110,071	20,811	130,882	116,380	20,811	137,191	123,577	20,811	144,389
Gjirokastër	285,728	16,182	301,911	301,460	29,130	330,590	318,631	29,130	347,762	337,221	29,130	366,351
Gramsh	286,762	18,031	304,793	304,078	32,458	336,536	322,260	32,458	354,718	342,176	32,458	374,634
Has	191,982	13,157	205,140	202,715	23,685	226,400	214,646	23,685	238,331	227,901	23,685	251,586

Roskovec	148,096	13,746	161,842	157,039	24,744	181,783	166,150	24,744	190,894	176,423	24,744	201,167
Rrogozhinë	195,957	12,149	208,106	207,790	21,870	229,660	220,025	21,870	241,895	233,627	21,870	255,497
Sarandë	180,074	16,350	196,424	188,177	29,433	217,610	196,645	29,433	226,078	205,494	29,433	234,927
Selenicë	228,819	11,813	240,632	242,636	21,265	263,901	257,036	21,265	278,301	272,924	21,265	294,189
Shijak	195,877	12,401	208,278	204,691	22,324	227,015	213,902	22,324	236,226	223,528	22,324	245,851
Shkodër	893,758	43,238	936,996	939,204	77,834	1,017,038	985,852	77,834	1,063,686	1,030,215	77,834	1,108,049
Skrapar	163,289	12,989	176,278	173,149	23,383	196,532	183,392	23,383	206,775	194,728	23,383	218,110
Tepelenë	114,721	10,805	125,525	119,883	19,450	139,333	125,278	19,450	144,728	130,915	19,450	150,365
Tiranë	3,435,480	297,050	3,732,530	3,590,077	534,728	4,124,805	3,751,630	534,728	4,286,359	3,920,454	534,728	4,455,182
Tropojë	272,814	14,250	287,063	288,760	25,651	314,411	306,417	25,651	332,068	325,345	25,651	350,997
Dimal	182,931	14,418	197,349	193,978	25,954	219,932	205,495	25,954	231,449	218,196	25,954	244,150
Vau i Dejës	299,147	21,224	320,371	316,347	38,205	354,552	335,759	38,205	373,965	356,499	38,205	394,704
Vlorë	761,086	37,440	798,527	799,786	67,398	867,183	839,509	67,398	906,907	877,287	67,398	944,685
Vorë	173,293	22,148	195,441	181,091	39,869	220,960	189,240	39,869	229,109	197,756	39,869	237,625
Total	**22,006,781**	**1,489,808**	**23,496,589**	**23,206,884**	**2,681,851**	**25,888,735**	**24,480,802**	**2,681,851**	**27,162,653**	**25,831,772**	**2,681,851**	**28,513,623**

Në mijë lekë

Qarqet	2024	2025	2026	2027

SHTOJCA 3

TREGUESIT KRYESOR TË KUADRIT MAKROEKONOMIK E FISKAL 2025-2027

1. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën 2025-2027, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

në milionë lekë

Vitet	2025	2026	2027
Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme	25,577	26,905	28,286

2. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për periudhën 2025-2027, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

në milionë lekë

Vitet	2025	2026	2027
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	10,800	10,950	11,090

3. Transferta Sektoriale për Pagat për periudhën 2025-2027, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

në milionë lekë

Vitet	2025	2026	2027
